



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Psikologji Zhvillimi

Ngarkesa: 4 ECTS, 26 leksion, 13 Seminar

Viti, semestri kur zhvillohet: Vit I, Sem1

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në Mësuesi të Gjuhës Angleze për Arsimin e Mesëm të Lartë

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Lënda *Psikologji zhvillimi* zhvillohet në semestrin e parë të vitit të parë të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në Mësuesi të Gjuhës Angleze për Arsimin e Mesëm të Lartë.

Studentët do të njihen me metodat shkencore dhe teoritë kryesore të psikologjisë së zhvillimit për këto etapa të cilat prekin aspektet biologjike, kognitive, emocionale e sociale të zhvillimit. Ata do të udhëhiqen dhe mbështeten në lidhje me aspektet praktike të aplikimit të psikologjisë së zhvillimit në kontekstin shoqëror shqiptar. Përfundimisht studentët do të aftësohen për të transferuar njohuritë teorike/empirike në kontekstin specifik social-kulturor shqiptar si dhe do të pajisen me aftësi kritike-analitike të domosdoshme për të realizuar këtë proces.

Rezultatet e të nxënit:

Në fund të kursit studentët do të pajisen me Njohuri mbi:

- a. Karakteristikat e zhvillimit në moshën e fëmijërisë së hershme, vonë, dhe adoleshencës
- b. Teoritë kryesore të zhvillimit në dimensionet bio-psiko-sociale të zhvillimit të individit

2 . Aftësi:

- a. Për të menduar në mënyrë kritike në lidhje me teoritë e zhvillimit, duke analizuar pikat e forta dhe të dobëta si dhe kontributet e tyre
- b. Për të analizuar rastet studimore bazuar mbi teoritë dhe kornizat konceptuale ekzistuese

3 . Kompetenca në:

- a. Identifikimin dhe zbatimin e treguesve zhvillimorë të individit në aspektet biologjike, psikologjike dhe sociale.
- b. Analizën e faktorëve të ndryshëm në krijimin e problemeve në zhvillim në raste konkrete studimore